



## Smaltolux Extra

Llak druri me cilësi maksimale



**Rendimenti i mbulimit: 16 - 18**

m<sup>2</sup>/lt



**Koha e tharjes: 2 - 4 orë**



**Hollimi: 4 % për vëllim në Smaltoux White Spirit**

ose deri në 4 % për vëllim në Holluesin nr. 1



**Mundësia për shtresë të dytë:**

16 orë



**Paketimi:**

I bardhë me shkëlqim: 375 ml, 750 ml, 2,5 lt, 5 lt

I bardhë saten: 750 ml, 2,5 lt, 5 lt

E bardhë mat: 750 ml, 2,5 lt

I zi mat: 750 ml

**Aplikimi:** Me furçë, rul, pistoletë me ajër

### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Llak druri me cilësi të lartë i gjeneratës së re, i përshtatshëm për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, me përmbajtje të ulët të POA dhe me pak aromë gjatë aplikimit. Ideal për aplikime në sipërfaqet prej druri dhe metali. Siguron veshje të përsosur dhe forcë të shkëlqyer mekanike. Ruan shkëlqimin dhe është së tepërmi rezistent ndaj ujit. Një zgjidhje ideale për rinovime falë performancës së tij të lartë të mbulimit. Përhapet në mënyrë fantastike dhe është e lehtë për t'u punuar. Ka rezistencë të shtuar ndaj zverdhjes dhe veti të shkëlqyera tharjeje. Nuk përmban plumb dhe krom. I disponueshëm në veshje me shkëlqim, saten dhe mat.

Për të shmangur zverdhjen në ambiente të brendshme me ndriçim të dobët, rekomandohet të përdoret llaku me bazë uji SMALTOLUX Hydro.

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

<b>Shkëlqimi</b>	<b>Me shkëlqim:</b> 88 - 90 njësi në 60° & 78 - 80 njësi në 20° <b>Saten:</b> 20 - 30 njësi në 60° <b>Mat:</b> 6 - 7 njësi në 60°
<b>Graviteti specifik</b>	<b>Me shkëlqim:</b> 1,21 - 1,29 kg/lt (i bardhë)/ 0,94 - 1,20 kg/lt (nuanca). <b>Saten:</b> 1,33 - 1,38 kg/lt (i bardhë). <b>Mat:</b> 1,38 - 1,42 kg/lt (i bardhë).
<b>Rendimenti i mbulimit</b>	16 - 18 m <sup>2</sup> /lt për shtresë, në varësi të sipërfaqes.
<b>Hollimi</b>	Deri në 4% për vëllim duke përdorur holluesin SMALTOLUX WHITE SPIRIT për aplikim me furçë ose rul dhe për aplikim me pistoletë për spërkatje pa ajër deri në 4% për vëllim me holluesin nr. 1 nga VECHRO.
<b>Koha e tharjes</b>	E thatë për tu prekur për 2 - 4 orë.
<b>Mundësia për shtresë të dytë</b>	Mund të rilyhet pas 16 orësh dhe pas ngurtësimit të plotë të shtresës së parë. Këto afate kohore janë më të gjata në kushte të ftohta dhe me lagështirë.
<b>Kategoria e POA</b>	"Dekorime të brendshme/të jashtme dhe veshje prej druri dhe metali". Lloji D. Vlera e pragut të POA = 300 gr/lt. Përmbajtja maksimale e POA për produktet e gatshme = 295 gr/lt. Boja gjithashtu përmban tretës jo POA. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikë vllimi < 250°C.
<b>Ngjyrat</b>	<b>Me shkëlqim, saten:</b> I bardhë dhe në mijëra nuanca përmes sistemit të krijimit të nuancave COLOR MOOD. <b>Me shkëlqim:</b> nuancat e gatshme <b>Mat:</b> E bardhë, e zezë



## ΠΕΡΓΑΤΙΤJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet duhet të pastrohen nga pluhuri, yndyrat, vaji, bojërat e vjetra të rrjepura, pjesët e lirshme, etj. Para aplikimit, rekomandohet smerilim i mirë, veçanërisht nëse është bojë vaji e vjetër dhe gjithashtu kërkohet pastrimi i duhur i pluhurit. Lyeni sipërfaqet prej druri me 1-2 shtresa astar SMALTOLUX VELATOURA, sipërfaqet prej metali me 1 shtresë astar kundër gërryerjes OXIDOL.

## APLIKIMI

Përziheni mirë. Aplikoni një ose dy shtresa SMALTOLUX extra të holluara sa duhet.

## PASTRIMI I MJETEVE

Gjatë punës, mbajini mjetet "të njoma" në enë ose në tabakanë me bojë. Kullojeni bojën mirë nga mjetet kur ta hidhni përsëri në enë dhe pastrojini ato me tretësin nr. 1 të VECHRO, me ujë të nxehtë dhe sapun.

## KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8 - 30 °C dhe niveli relativ i lagështisë më i ulët se 80 %. Kushtet e këqija gjatë aplikimit mund të ndryshojnë vetitë e produktit në fund.

## RUAJTJA

Ruajini në një vend të freskët, mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell. Mbylleni fort enën pas aplikimit. Rimerreni bojën që ka tepruar për ta përdorur përsëri. Ripërdorimi i ngjyrave mund të minimizojë ndjeshëm efektet në mjedis të ciklit të jetës së produkteve.

## SHËNIME

Për më shumë informacion për substancat e rrezikshme të produktit, shihni Fletën e të Dhënave të Sigurisë së Materialit të produktit (FDSP).

## UDHËZIME PËR PËRDORIM TË SIGURT

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Mbajeni larg fëmijëve.



Të dhënat dhe udhëzimet teknike në këtë broshurë teknike bazohen në testet laboratorike dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001, 14001 dhe me rregulloren e EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.